

VENDIM
Nr.593, datë 5.9.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES TË SË NDJERËS ALTINA TOMORRI, QË HUMBI JETËN NGA ZJARRET, QË PËRFSHINË DITËT E FUNDIT, GREQINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare prej 1 000 000 (një milion) lekësh, familjes të së ndjerës Altina Tomorri, banore e fshatit Velmish, në komunën Strumë të qarkut të Fierit, që humbi jetën nga zjarret, që ranë ditët e fundit, në Greqi.

2. Prefektit të qarkut të Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, të cilin t’ia japë përfaqësuesit të familjes së viktimës, në përputhje me dokumentet dhe procedurat ligjore në fuqi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshme dhe prefekti i qarkut të Fierit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha